

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
II Nr./Br. 221/22
Nr. i lq./Br. st. - 8 -
Dato / Datum 16.9.2022
VUSHTRRI - VUČITRN



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 korrik 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Alban Bajrami.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), Drejtoret e drejtive, Haki Maloku, nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se kemi katër pika shtesë, të cilat janë propozuar për t'u futur në rend të ditës.

Ajo tha se përmes postës elektronike ju ka ardhur një propozim për t'u futur në rend të ditës nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim <Shqyrtimi i Planit për vlerësim të rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë>, kurse sot na kanë ardhur dy pika për t'u futur në rend të ditës: <Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022>, <Shqyrtimi i Propozim – vendimit për transferin e mjeteve financiare të komunës>. Ajo tha se përvèç planit të punës së kuvendit që e kanë drejtorië, sekretaria e kuvendit ua rikujton përsëri drejtoreve të drejtive pikat që kanë për t'i sjell qoftë në KPF apo në kuvend, por prapë se prapë materialet po vijnë me vonesë. Prandaj, ajo kërkoi nga drejtoreti që materialet të na vijnë mundësish me kohë.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se është obligim ligor që kur të bëhet bartje e mjeteve financiare prej një programi në një program tjeter, të dërgohet edhe në KPF, prandaj kjo është arsyaja që e kemi sjelli.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – propozoi që të futet në rend të ditës <Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh>. Kjo është kërkësë edhe e Agjencionit kundër korrupsionit, por edhe e disa deputetëve që disa herë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës pika 5 <Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shkarkim të komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë>, për arsy se kam informacione se ka proces të ankimit, kështu që mos të ndërhyjmë derisa të përfundojnë procedurat:

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se pas shumë tentativave me i ik debatit që po vazhdon edhe sot. Unë nuk mendoj që duhet të shtyhet ajo pikë e rendit të ditës. Vet arsyetimi i kryetarit ka qenë që komisioni ishte i njëanshëm, aty është bërë një shkelje. Atëherë shtronhet pyetja se kush e ka bërë vlerësimin se komisioni ka qenë i njëanshëm? Sepse, ekziston komisioni i ankesave në komunë që mund ta verifikonte nëse ka pasur shkelje, por jo direkt kryetari i komunës. Por, qe po parashykojmë se ka pasur të drejtë kryetari se komisioni ka qenë i njëanshëm, atëherë sot është dashur të na vijnë masat që janë ndërmarrë kundër anëtarëve të komisionit vlerësues. Prandaj, nuk pajtohem që të hiqet nga rendi i ditës.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – sipas legjislacionit, një shërbyes civil, si anëtarë komisioni nuk mundesh me penalizu, por mundesh me ia propozu kuvendit për shkarkim nga komisioni. Ai tha se unë e kam vlerëuar njëanshmërinë e komisionit. Prej momentit që kam ardhur në detyrë, ka marrë fund që t'i punësojë të afërmit, gratë e farefisin. Pse kam vlerëuar se ka pasur subjektivizëm? Në shkollën e Pestovës, një mësimdhënëse që ka licencë për drejtoreshë, mbi dhjetë vite e ka ushtruar atë detyrë dhe nuk është zgjedhur. Është rekomanduar nga komisioni një kandidate që ka lidhje miqësie me mua (është gruaja e mikut). E dyta, komisioni nuk ka dhënë arsyetime, pra komisioni është dashur ta përgatis një raport me arsyeshmëri për rekomandimet e tyre për drejtore.

Edhe te rasti në Druar, nëse një kandidat ka qenë për 7-8 vite drejtor shkolle, i përgatitur, ka qenë drejtor i Drejtorisë për Arsim, edhe po zgjedhet një kandidat tjetër pa një raport të komisionit që të sqarohet rekomandimi i tyre.

Te rasti i shkollës “A. Z. Çajupi”, kandidati që është rekomanduar për drejtor, ishte tek unë në takim në cilësinë e kryetarit të sindikatës. Prandaj, ai është dashur ta ngrijë pozitën si kryetar i sindikatës.

Prandaj, këto janë disa, por edhe disa çështje tjera, për të cilat kam thënë se është bërë vlerësim i njëanshëm nga komisioni dhe kam deklaruar se nuk i nënshkruar kontratat.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se asnjë interes as politik e as familjar nuk kam me kandidatët për drejtor dhe as që i njoh as personalisht e as familjarisht. Ne si grup kuvendar i kemi pasur rezervat tona me këtë komision kur ka ardhur në kuvend për ta formuar komisionin. Anëtarët e subjektit tënd politik e kanë mbrojtur komisionin duke i quajtur profesionistë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, dy (2) “kundër” aprovoi këtë:**

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.6.2022;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021;
3. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit për përkrahje financiare;
8. Shqyrtimi i Planit për vlerësim të rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për transferin e mjeteve financiare të komunës;

10. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022;
  11. Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadhd;
  12. Të ndryshme.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.6.2022.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me shtatë (7) vota “për”, aprovoi procesverbalin e datës 16.6.2022.**

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se raporti i auditimit për vitin paraprak jep opinion jo të mirë për komunën tonë, edhe pse në atë kohë kanë bashkëqeveris LDK – VV. Prandaj, neve nuk na gëzon fakti që kemi marrë një opinion të tillë, sepse si komunë do të penalizohemi, ku kjo do të ndikojë edhe në tri vitet e ardhshme për humbje të granteve të performancës. Pra, për shkak të qeverisjes së dobët LDK – VV, do të penalizohemi për tri vitet e ardhshme me humbje të granteve.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se është për keqardhje niveli i Ilmiut, nëse duhet diçka për vetëkontroll, duhet të bëhet vetëkontroll të tenderëve. Janë tre tenderë që janë dhënë për familjarë. Është shpifje ajo që e tha Ilmiu për bashkëqeverisjen LDK – VV në vitin 2021, sepse ne jemi përjashtuar nga koalicioni në janar 2021. Në tri vitet që ne kemi qeverisur, nuk ka pasur raport të kualifikuar të auditorit. Prandaj, kërkoi prej teje kryetar që të keni konsideratë për gjuhën dhe tentimin për ta ndaluar gjuhën nga subjekti yt politik tash e disa seanca, sepse nuk do ta tolerojmë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – deklaroi se është kryetar i komunës dhe se nuk përfaqëson subjekt politik dhe e kam atë guxim ta them. Pra, unë i përfaqësoj interesat e qytetarëve të komunës për aq sa di. Prandaj, kërkoi që ta krijoni një frysë konstruktive.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – theksoi se fjalori i Ilmiut lidhur me qeverisjen e LDK-së në vitin 2021, ku unë kam qenë pjesë e asaj qeverisje, është për keqardhje. Kam qenë drejtor i Drejtorisë për Inspektime dhe e kam kryer me nder atë detyrë dhe mburrem me punën që e kam bërë. Por, është mirë që të pendohen asamblistët, të cilët ju kanë drejtuar zyrës së inpeksionit për kërkësat e tyre të papërgjegjshme, ku e kanë marrë edhe ndëshkimin e merituar. Prandaj, kryesuesja duhet t'i përcjell fjalimet e të gjithëve dhe mos t'i lejoj ta kalojnë kodin e etikës.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – theksoi se secili këtu jemi të pjekur dhe e dimë se çka na lejon rregullorja dhe etika morale dhe njerëzore. Prandaj, ju lus që ta keni parasysh këtë si në komitet, po ashtu edhe në seancë të kuvendit.

**Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”,asnje “kundër” dhe dy (2) abstenime rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.**

3. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se te <administrata dhe personeli, taksë administrative>, buxheti i planifikuar për këtë periudhë është 35,000.00€, kurse të hyrat e realizuara janë 34,898.00€, ku sipas këtyre përqindja e realizuar e buxhetit është 100%. Nuk duhet me qenë ekspert për ta kuptuar këtë, 35,000.00€ në raport me 34,898.00€ nuk janë 100%. Tek Drejtoria për Inspektime, realizimi i buxhetit është 70% që është një përqindje e ultë e të hyrave vetanake dhe po ashtu mungojnë të hyrat vetanake të shëndetësisë, ose mua nuk më kanë ardhur si material.

Kërkoj nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në mbledhje te kuvendit të na sjell një raport për mëditjet jashtë vendit, me theks të veçantë homazhet tek varri i Hasan Prishtinës në Kukës (kush janë zyrtatët që i kanë marrë mëditje). Konsideroj se është e turpshme të shkohet për homazhe deri në Kukës dhe të merren mëditje, sidomos për simbolikën e Hasan Prishtinës, i cili e ka shkrirë pasurinë, e ne e shfrytëzojmë për të marrë mëditje, gjë që nuk ka qenë praktikë për tri vjet në kësot raste sa kam qenë në komunën.

Po ashtu, tek kodi 13620 <furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)> në vitin 2021 kanë qenë 6,184.32€, kurse në vitin 2022 (për periudhën e njëjtë) janë rritur në mënyrë enorme, ku janë 63,541.95€. Kërkoj sqarime se ku janë adresuar këto furnizime.

Ndërkaq, tek pjesa e investimeve kapitale, buxheti i planifikuar dhe buxheti i shpenzuar në shumicën absolute të shtyllave është zero. Pse, nuk kemi asnë projekt që ecën dhe që shpenzohet paraja publike në dobi të investimeve kapitale dhe interesit qytetar.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – theksoi se kam qenë në Selanik dhe e kam vizituar shtëpinë e Hasan Prishtinës, ku i kam paguar: 120€ naftë, kartonin e gjelbër, hotelin me para të mia. Për Hasan Prishtinën ja ka vlejtë me bë atë rrugë.

Sa i përket investimeve kapitale, këtë vit e kemi shumë të rënduar, sepse tek në muajin maj është lëshuar buxheti në qarkullim. Po ashtu, kemi problem me operatorët ekonomikë, sepse disa kontrata kanë qenë dyvjeçare dhe janë rritur çmimet në mënyrë enorme, ku dy kompani janë lajmëruar për ndërprerjen e kontratave.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se të gjitha ato që i kërkoi asamblisti do ja jap edhe tash, sepse i kam të shtypura në letër.

Lidhur me kodin 13620, mund t'i jap për secilën pagesë që është bërë veç e veç.

Se pse mungojnë të hyrat vetanake të shëndetësisë, Ahmeti tha se nuk kanë pasur raport nga shëndetësia dhe për këtë nuk janë paraqitur në raport.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – sa i përket investimeve kapitale 2021/2022, tha se kanë ngetur kontratat kornizë dyvjeçare për shkak të rritjes së çmimeve dhe kjo nuk ka ndodhur vetëm në komunën tonë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kërkoi përgjigje me shkrim lidhur me disa dallime aq të mëdha të shpenzimeve, krahasuar me vitin paraprak për këto kode: <shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit>, <shpenzimet e tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit>, <mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit>, <akomodimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit>, <shpenzimet e tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit>, <shpenzimet për internet>, <shpenzimet e telefonisë mobile>, <shpenzimet postare>, <shpenzimet e arsimit dhe trajnimit>, <shpenzimet e përfaqësimit avokaturë>, <furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)>.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2022.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se fatmirësisht shumica e vendimeve të kuvendit për këtë periudhë janë të zbatuara.

Tek vendimi për ndërrimin e destiminit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Suphi Metëhiu), tek ky rast sa jam i informuar, departamenti i zyrës ligjore i Ministrisë së Bujqësisë ka dekluaruar se kësaj prone nuk mund t'i ndërrohet destinimi dhe këtu tek arsyeva eshtë cekur. Nëse eshtë rasti kështu, atëherë sipas procedurës ky vendim duhet të kthehet në kuvend për shfuqizim.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – kërkoi informatë se deri ku ka shkuar zbatimi i vendimit për identifikimin e shtëpive - shkolla. Meqenëse zotimi ka qenë që në Ditën e Çlirimtë të përfundojë kjo çështje. Po ashtu, ai pyeti se vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër a do të mbetet aty, apo do ta shëtisim prapë në ndonjë vend tjetër.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se vendimi për emërtimin e lagjeve urbane në qytet (qershor) po figuron në procedurë. Kërkoi informatë se çka ka ndodhur me këtë vendim.

**Haki Maloku, nga zyra e kryetarit** – tha se vendimi eshtë dërguar në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë dhe nuk kemi ende një përgjigje, prandaj figuron ende në procedurë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – lidhur me vendimin për identifikimin e shtëpive - shkolla, tha se sa jam në dijeni nuk ka qenë që të përfundohet deri në Ditën e Çlirimtë, sepse ka qenë afati shumë i shkurtër. Por, ka qenë që përgatitja e pllakave dhe vendosja e tyre të bëhet për Ditën e Mësuesit (7 mars 2023). Komisioni eshtë duke e kryer punën e tij dhe sapo të bëhet identifikimi i të gjitha shtëpive – shkolla, do t'i sjellim në kuvend.

Lidhur me vendimin për ndërrimin e destiminit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Suphi Metëhiu) edhe unë e di që ka pasur një problem me ministri dhe tjetër informacion nuk kam.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – lidhur me vendimin për identifikimin e shtëpive – shkolla, në mbledhjen e muajit shkurt kemi diskutuar dhe për shkak se për 7 mars ka qenë koha e shkurtër, patëm vendosur që të bëhet për Ditën e Çlirimtë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – ke të drejtë, se ideja ka qenë për Ditë të Mësuesit, por shkak që ka qenë kohë e shkurtër, për Ditën e Çlirimtë nuk e kemi futur në agjendë, por e kemi lënë për 7 mars 2023.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se para se të bëhen pllakat, eshtë mirë të vjen lista në kuvend dhe të shohim se mos eshtë harruar ndonjë shtëpi – shkollë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – patjetër që lista do të vijë në kuvend, sepse komisioni e ka mandatin e kuvendit dhe do të vijë me raportu në kuvend.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për themelimin e komisionit për përgjedhjen e këshillave lokale.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se anëtari i shtatë (përfaqësuesi nga fshati, vendbanimi ose lagjja urbane) nuk mund të caktohet, sepse i njëjtë anëtarë nuk mund të jetë për të gjitha këshillat. Por i mbetet komisionit në bashkëpunim me drejtorinë gjegjëse ta caktojë për secilën lagje apo fshat.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – theksoi se është mirë që të bëhet kompensimi i anëtarëve të komisionit, sepse Komuna e Mitrovicës është duke e bërë një gjë të tillë. Po ashtu, edhe kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – deklaroit se ka qenë vendim i kuvendit që kryetarët e këshillave lokale të kompensohen.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – theksoi se nuk humb komuna e as shteti nëse paguhet komisioni për punën e tij, sepse është një motivim i vogël.

**Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se të gjitha vendimet që kanë ardhur së bashku me procesverbal nga kryetarët e këshillave janë kompensuar. Por, ka pasur raste që edhe përmes procedurave përbëmbarimore i kanë marrë mjetet.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim të ekonomive familjare nga pagesa e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – tha se nëse veç merret një vendim i tillë, të bëhet lirimi nga pagesa edhe atyre që i kanë paguar mjetet më herët.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – theksoi se PDK-ja edhe atëherë kur u vendos taksa ka qenë kundër, por koalicioni i atëhershëm ka menduar se është veprim i duhur. Por, nëse ekziston mundësia ligjore do të ishte mirë që t'i u kthehen të gjithëve mjetet financiare që kanë paguar për kyçje.

Prandaj, është mirë që të merret një opinion nga zyra ligjore se a ka bazë ligjore për një gjë të tillë.

Po ashtu, edhe një raport me shkrim se sa është vlera e participimit në komuna nga fshatrat.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – ky ka qenë një vendim i kryetarit, sepse nuk kam gjetur që ka vendim të kuvendit. Nuk është marrë një vendim për të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, por një vendim për fshatrat që nuk kanë rrjet të ujësjellësit, që është bërë me një kontratë – kornizë trevjeçare nga “Ilea Group”, ku brenda kësaj kontrate do të bëhet participimi. Nëse është vendim i padrejtë, edhe atëherë ka qenë vendim i padrejdë dhe selektiv.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se mirë që e mori fjalën drejtori dhe e demantoi Ilmiun, sepse s'ka qenë vendim i kuvendit dhe se s'kam mundur të votojë kundër kur nuk ka qenë fare në kuvend.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i kërkesës së Pranvera Hysenit për përkrahje financiare.

**Fatmire Cecelia, anëtar e KPF-së** – deklaroi se e përkrahin si kërkesë dhe se krenohemi me punën e Pranverës gjatë rrugëtimit të saj, të cilën sa kam qenë drejtoshë e kemi propozuar për mirënjojje, që pastaj me vendim të kuvendit i është ndarë mirënjojja.

Kam dëshirë që ta përkrahim këtë projekt, por mos të bëhet praktikë të ndahen subvencione pa procedura, pra të bëhet përmes thirrjes publike.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – edhe unë jam shumë e interesuar t'i ndihmojmë Pranverës, por jo jashtë ligjit.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – theksoi se askush nuk e konsteston projektin e Pranverës dhe i duartrokasim arritjeve shkencore të saj. Por, sa kemi humbur kohë që ta sjellim në KPF e të pritet deri në seancë të kuvendit, e të pritet deri në vlerësim të ligjshmërisë nga MAPL, më mirë do të ishte të shpalley një thirrje publike nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mos me humb kohë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se mbajtja e festivalit të astronomisë është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jemi shumë krenar që Pranvera është bashkëvendase e jona dhe mbahet në qytetin tonë. Nëse bëhet me shpallje publike nuk mund të vendos limite që mos me konkurru edhe OJQ tjera, sepse thirrja është e hapur për të gjithë.

Prandaj, të procedohet për kuvend dhe ta përkrahim bashkërisht këtë projekt.

**Haki Maloku, nga zyra e kryetarit** – theksoi se sa e di kjo nuk është OJQ, por është person fizik. Thirrja publike bëhet për OJQ, jo për persona fizik. Në anën tjetër, thirrja publike për ndarje të subvencioneve për këtë vit ka përfunduar

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Shqyrtimi i Planit për vlerësim të rrezikut për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se na ka ardhur si material me vonesë në e-mail dhe nuk kam pasur mundësi ta lexoj. Por, sa e lexova pak këtu, e pashë që është një plan shumë mirë i punuar dhe i përgëzoj hartuesit dhe kërkoj që të publikohet në uebfaqe.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për transferin e mjeteve financiare të komunës.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2022.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

11. Rishqyrtimi i vendimit nr. 81/21 i datës 16.4.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – kërkoi nga propozuesi të na sqarojë se cili është qëllimi i kësaj pike të rendit të ditës, pasi që s'ka material, le të na arsyetojë se çka është në pyetje.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se lidhur me këtë pikë, Agjencioni kundër korruptionit ka kërkuar që të rishqyrtohet në kuvend ky vendim, duke marrë për bazë konfliktin e mundëshëm të interesit për dy anëtarë të kuvendit, pjesëmarrës në vendim, që është fjala për mua dhe Fitim Halilin. Pranimi teknik i zonës industriale është bërë, kështu që duhet t'i jepet një kahje kësaj çështjeje. Prandaj, kjo është arsyaja që e propozova dhe qeveria komunale duhet ta përgatis dokumentacionin për kuvend.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se është kundër që të rivotohet ky votim. Kjo duhet të shkojë në rishqyrtim komplet, duke filluar nga shpallja publike, konkursi, e deri te kontrata që është bërë me operatorët, sepse flitet që aty ka pasur shkelje prej kur është themeluar komisioni e deri në fund, ku ka raste që është bartur fleta poseduese tek pronari i tretë. Ai tha se iu bën thirrje asamblistëve që të mos përkrahet një e keqe.


**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë pikë, nuk marrë pjesë fare në votim, sepse nuk e di çka po votojë, pasi që nuk ka material.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tri (3) vota “për”, tri (3) “kundër” dhe një (1) abstenim rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

12. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **16:00**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së